

Konkluzion nga Konsultimi Publik

'Draft Rregullorja për Autorizime të përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare'

Kjo Rregullore është nxjerrë në bazë të nenit 4 paragrafi 1), nenit 7 paragrafi 2.1) dhe paragrafi 2.2), nenit 16 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 3.1), nenit 20, nenit 21, dhe 22, të Ligjit Nr. 06/L-38, për Shërbime Postare, dhe sipas Vendimit Nr. 1343, të datës 21/03/2019, ARKEP ka miratuar fillimin e procedurave të Konsultimit Publik, e cila ka zgjatur nga data 21 Mars deri më 5 Prill 2019.

Gjatë kësaj periudhe komente janë pranuar nga NPQ' Posta e Kosovës' ShA., (Ref, E-mail, SENT; Tue 4/2/2019 2:04 PM, FROM; Salih Morina [salih.morina@postaks.onmicrosoft.com] TO; nazim.rahimi@arkep-rks.org, SUBJECT; RE: Hapja e Procesit të Konsultimit Publik lidhur me Rregulloren për Autorizime të Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare)

Bordi Drejtues i Autoritetit pas shqyrtimit të komenteve të pranuar, në mbledhjen e 38-të, të mbajtur më datë; 10/04/2019, ka miratua Rregulloren së bashku me përgjigjet/sqarimet e ARKEP, në komentet e dërguara dhe të përmbledhura si në vijim:

Nr.	Referenca në Rregullore	Komentet ne Draft Rregulloren per Autorizimin e Përgjithshem per ofrimin e shërbimeve postare NPQ 'Posta e Kosovës' ShA.	Komentet dhe përgjigjet e ARKEP-it
1	Neni 2 Qëllimi dhe Fushëveprimi Qëllimi i kësaj Rregullore, është vendosja e rregullave, përcaktimi i procedurave dhe kushteve të ofrimit të shërbimeve postare, në Republikën e Kosovës, nga ndërmarrësit që ofrojnë shërbime postare nën regjimin e 'Autorizimit të Përgjithshëm', e që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar.	Neni 2 Qëllimi dhe fushëveprimi 2.1. Fjala "Nëndermarrësit" të zëvendësohet me fjalën Ofruesit 2.1. Poashtu fjala ' regjimin' të zëvendësohet me fjalën kushtet	Komenti në nenin 2 paragrafi 2.1.; <u>PRANOHET PJESËRISHT</u> , dhe do të zëvendësohet në pjesë të caktuara të Rregullores. Komenti i dytë në nenin 2 paragrafi 2.1; <u>PRANOHET PLOTËSISHT</u> dhe do të zëvendësohet në tërë tekstin e Rregullores.
2	Neni 3 Termet dhe Përkufizimet i) Dërgesa postare me Shumicë - është posta që konsiston në dërgimin e një sasive të madhe dërgesash postare identike (letra të së njëjtës natyrë ose reklama) që dërgohen në adresa individuale me çmim më të lire se tarifat standarde, për të cilat	Neni 3 Termet dhe perkufizimet i) te definohet përkufizimi sipas ligjit ne fuqi (neni 3 pika 1.9)	Komenti i nenit 3 në pikën i) <u>PRANOHET PLOTËSISHT</u> , dhe do të merret definicioni ashtu siç është i përcaktuar në pikën 1.9 të nenit 3 të LSHP.

	<p>pagesa kryhet në total;</p> <p>k) Shërbimi i shkëmbimit të dokumenteve – Shërbimi që ofron mjetet (facilitetet), duke përfshirë ofrimin e ambijenteve për depozitim nga ana e dërguesit dhe marrjen nga ana e të adresuarit, të dy të abonuar për të realizuar këtë shërbim të dërgesave postare;</p>	<p>k) te definohet me gjerësisht dhe me kujtë çka krejt nënkupton.</p>	<p>Komenti i nenit 3 në pikën k) NUK PRANOHET,</p> <p>Ky definicion nuk është i paraparë në LSHP, por është në përputhje me Nenin 2, paragrafi 12) të Direktivës 97/67/EC, dhe përkufizon mundësin e shkëmbimit të dërgesave përmes faciliteteve – pajisjeve (Automatëve të ndryshëm, Postal Box, etj), për shfrytëzuesit që janë të regjistruar ose abonuar për të kryer këto shërbime.</p> <p>Nenin 2 paragrafi 12 i Direktivës 97/67/EC, thotë:</p> <p><i>‘12. document exchange: provision of means, including the supply of ad hoc premises as well as transportation by a third party, allowing self-delivery by mutual exchange of postal items between users subscribing to this service;’</i></p>
3	<p>Neni 5 Llojet e dërgesave postare</p> <p>(1) Llojet e dërgesat postare, kur personat fizik ose juridik të interesuar dëshirojnë të ofrojnë shërbime postare, të cilat nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar, përfshijnë:</p> <p>1.1 dërgesat e korrespondencës, 1.2 pakot postare, 1.3 dërgesat e regjistruara, 1.4 dërgesat e siguruara; 1.5 dokumenta biznesi; 1.6 libra; 1.7 katalogë; 1.8 gazeta; 1.9 revista; dhe 1.10 mallra me ose pa vlerë tregtare.</p>	<p>Neni 5 Llojet e dërgesave postare</p> <p>A është menduar që të gjithë këto lloje të dërgesave të jenë në shërbimin Express</p>	<p>SQARIM i ARKEP për nenin 5;</p> <p>Te gjitha këto lloje të dërgesave janë në nomenklaturën e shërbimeve postare dhe në kuadër të shërbimeve postare dhe mund të ofrohen apo realizohen me shërbimin e shpejtë Express dhe shërbimin Jo Express.</p>
4	<p>Neni 7 Autorizimi i Përgjithshëm</p> <p>‘Autorizimi i Përgjithshëm’, vendos dhe përcakton kushtet e përgjithshme të ofrimit të</p>	<p>Neni 7 Autorizimi I përgjithshëm</p> <p>(2). Fjala “perpunim” të sqarohet a është në pajtim me ligjin, që të jetë e përfshirë në këtë kontekst të</p>	<p>SQARIM i ARKEP për nenin 7;</p> <p>Konsiderojmë se fjala ‘përpunim’ është plotësisht në përputhje me LSHP dhe përcakton qartë cili është procesi i përpunimit të dërgesave postare.</p>

	shërbimeve postare, ashtu si paraparë në Shtojcën III, të kësaj Rregullore, e që duhet ti respektojnë të gjithë ndërmarrësit apo sipërmarrësit që dëshirojnë të ofrojnë shërbime postare. 'Autorizimi i Përgjithshëm' mbulon të gjitha proceset ose pjesë të caktuara të proceseve të pranimit, përpunimit, transportit, shpërndarjes dhe dorëzimit të dërgesave postare	ketij neni.	Në këtë rregullore me përpunim është specifikuar dhe qartësuar për ofruesit e shërbimeve postare se Autorizimi i Përgjithshëm mund të mbulojë të gjitha proceset ose njërin prej proceseve nga pranimi deri tek dorëzimi dhe shpërndarja e dërgesave postare. Praty është qartë e specifikuar se citoj; <i>'Autorizimi i Përgjithshëm' mbulon të gjitha proceset ose pjesë të caktuara të proceseve të pranimit, përpunimit, transportit, shpërndarjes dhe dorëzimit të dërgesave postare'.</i>
5	Nuk ka Referencë	Konsiderojme se fjala 'ndërmarrësit' ne terminologjinë postare nuk do të duhej të përdoret dhe ne vend të saj të përdoret fjala Ofruesit, ne tere tekstin e kesaj Rregulloreje te zevendesohet kjo fjale. Poashtu te perdoret fjala "Ofruesit" te perdoret dhe zevendesohet ne tere tekstin e rregullores ku eshte perdore fjala "ndërmarrësit".	SQARIM: Komenti është pranuar ashtu siç është thënë edhe më lartë në Komentin Nr. 1.
6	Nuk ka Referencë	Posta e Kosoves sh.a. si Operator publik Postar e ka interesin dhe qellimin e definimit te kjarte te fushes e operimit te shërbimit postar, jashtë zonës se shërbimit universal postar ne kete Rregullore.	